

**VENDIM**  
**Nr.897, datë 29.12.2007**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE, PËR KURIMIN E ZNJ.ARMINDA GJONI, NË TURQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27, 11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Ministrit të Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 4 062 639 (katër milionë e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekësh, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj.Armina Gjoni, në klinikën e patologjisë, në spitalin “Acibadem Hastanesi”, në Turqi.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Pagesat të bëhen pas paraqitjes së faturave origjinale nga institucioni i kurimit.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**